



REPubLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E
INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE

QENDRIMI I DHEZIME, SHKREJTI I LOKALIT
11.17003 ME 8.10.19



Empowered lives.
Resilient nations.

Nr. 1552 prot.

Tiranë më 4.10.2019

Lënda: Transparenca në Qeverisjen Vendore

I nderuar Z. Kryetar,

Së pari dëshirojmë t'ju përgëzojmë për mandatin dhe ju urojmë suksese në detyrën tuaj në shërbim të qytetarëve. Përfitojmë nga rasti të sjellim në vëmendjen tuaj një nga çështjet themelore për qeverisjen vendore, atë të demokracisë vendore me gjithë elementët e saj përfshirë transparencën, integritetin si dhe vendimmarrjen me pjesëmarrje dhe konsultim të publikut.

Transparenca në qeverisjen vendore është hapi i parë për një qeverisje që përmbush parimin themelor të kartës së autonomisë Vendore, atë të subsidiaritetit. Qeverisja transparente në nivel vendor është parim dhe prioritet thelbësor në kuadër të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Integritetit Evropian.

Në këtë kuadër, projektit STAR II – Konsolidimi i Reformës Territoriale dhe Administrative, i zbatuar nga UNDP në bashkëpunim të ngushtë me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale kanë hartuar Programin Model të Transparencës për Njësitë e Vetqeverisjes Vendore.

Me Urdhrin nr. 211, datë 10.09.2018 "Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore", Komisioneri ka miratuar këtë program duke përcaktuar datën 01 Janar 2019 si afatin e miratimit dhe publikimit të tij nga ana e secilës bashki.

Duke konsideruar rëndësinë e veçantë të transparencës dhe llogaridhënies së bashkive ndaj qytetarëve, në kuadër të 28 Shtatorit, ditës ndërkombëtare të së drejtë për informim, Zyra e Komisionerit dhe STAR II kanë bashkëpunuar për kryerjen e një monitorimi mbi zbatueshmërinë e programit model të transparencës.

Bashkëlidhur po ju dërgojmë rezultatet e monitorimit për bashkinë tuaj duke rekomanduar marrjen e masave për përmbushjen e detyrimeve, që burojnë nga Ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit", si prioritet të rëndësishëm të agjendës tuaj.

Gjithashtu, bëjmë me dije se monitorimi i radhës do të kryhet në muajin dhjetor.

Besnik DERVISHI
KOMISIONERI


Lirya ELTAYEB
PËRFAQËSUESE E PËRHERSHME
UNDP-së NË SHQIPËRI

Bashkia Shkodër


Bashkia Shkodër ka përbushur 79% të programit të transparencës. Grafikët e mëposhtëm paraqesin rezultatet e monitorimit të programit të transparencës sipas 7 fushave të tij.

■ Përbushur ■ Pa përbushur

Fusha 1. Organizimi dhe funksionimi i bashkisë



Fusha 2. Transparenca dhe llogaridhënia financiare



Fusha 3. Kërkesa për informim




Fusha 4. Shërbimet e kërkuara nga bashkia



Fusha 5: Legjislacioni

Legjislacioni rezulton i publikuar në faqe

Fusha 6. Pjesëmarrja qytetare në vendim-marrje



Fusha 7. Informacion tjetër

